



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 24 MAJ 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 17.05.2018 *(neni 44 i Rregullores)*.

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*.

3. Raporti i Këshillit të Ministrave “Për gjetjet dhe rekomandimet e raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë 2018” *(neni 18, pika 2, i ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit në Bashkimin Europian”)*. *(Neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave.

Paraqitet projektrezoluta nga propozuesi.

Pyetje

Diskutime

Shprehen grupet parlamentare.

Koha e votimit të projektrezolutës.

4. Raporti vjetor i veprimtarisë së Autoritetit të Medieve Audiovizive për vitin 2017 *(neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*.

Shprehet titullari i institucionit *(jo më shumë se 60 minuta)*.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për projektrezolutën.

Pyetje

Diskutime *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi ose 10 deputetë)*

Shprehen grupet parlamentare.

Koha e votimit të projektrezolutës

5. Raporti vjetor i veprimtarisë së Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2017 *(neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet titullari i institucionit – *(jo më shumë se 60 minuta)*.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për projektrezolutën.

Pyetje

Diskutime *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi ose nga 10 deputetë)*

Shprehen grupet parlamentare.

Koha e votimit të projektrezolutës

6. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 34/2017 “Për lirimimin e frekuencave të dixhital-dividentit”” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

Shprehen grupet parlamentare.

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

7. Projektvendimi “Për emërimin e një anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare *(neni 111 i Rregullores, votim i fshehtë me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehen grupet parlamentare.

Koha e votimit

8. Projektvendimi “Për shqyrtimin me procedurë të përsheptuar të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, si dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes” *(nenet 28, 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Koha e votimit

6. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi – Të futen mediet në sallë!

Seancën plenare të ditës së sotme e deklaroj të hapur!

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Ju njoftoj se vijon puna në komisionet parlamentare për shqyrtimin e çështjeve të parashikuara në rendin e ditës së sotme.

Në lidhje me çështjet e parashikuara në rendin e ditës së seancës së sotme, ju njoftoj se kryetari i AMA-s, Gentian Sala, dhe kryetari i Këshillit Drejtues të RTSH-së, zoti Traja, ndodhen me shërbim në Strasburg, kështu që nuk janë të pranishëm në këtë seancë. Prandaj të dyja çështjet dalin nga rendi i ditës dhe shtyhen për në seancën e ardhshme.

Njëherësh, ju njoftoj se tre deputetë të Grupit Parlamentar të LSI-së kanë paraqitur një kërkesë për të hequr nga rendi i ditës projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 34/2017 “Për lirimimin e frekuencave të dixhital-dividentit”” për arsye të mosshqyrtimit të tij nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, si komision për dhënie mendimi. Ndërkohë, ju rikujtoj se komisioni përgjegjës dhe komisioni tjetër për dhënie mendimi e kanë shqyrtuar këtë projektligj sipas afateve të përcaktuara në Rregullore. Në të tilla raste, në mbështetje të nenit 49 të Rregullores, përveç propozuesit, që diskuton jo më shumë se 3 minuta, ka të drejtë të diskutojë një folës pro dhe një folës kundër, jo më shumë se 2 minuta, mandej merret vendimi me votim të hapur nga seanca plenare.

Kush e do fjalën nga propozuesit?

Urdhëroni!

Kejdi Mehmetaj – Në kalendarin e punimeve, që është miratuar nga seanca, thuhet se përveç komisionit përgjegjës dhe komisionit tjetër për dhënie mendimi, edhe Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, është po ashtu komision për dhënie mendimi. Siç e kemi shpjeguar qartazi edhe te letra që ju kemi dërguar, si Kryetar i Kuvendit, ditën e martë komisioni është njoftuar për t’u mbledhur, është mbledhur në orarin zyrtar të njoftuar me shkrim sipas Rregullores së Kuvendit, por për shkak të mungesës së maxhorancës, kuorumi nuk është bërë dhe mbledhja nuk është zhvilluar. Si rrjedhim, në këtë komision nuk ka kaluar për dhënie mendimi ligji për të cilin ju thoni se duhet të jetë sot në rendin e ditës. Nuk ka pasur

një njoftim të dytë për mbledhje, si dhe nuk është zhvilluar një mbledhje tjetër në të cilën ky projektligj do të diskutohej.

Gjithashtu, në nenin 27 të Rregullores së Kuvendit, në pikat 2 dhe 4, thuhet qartë se në rast të mosmarrëveshjeve, e vetmja instancë, e cila mund të vendosë nëse duhet të jetë një komision për dhënie mendimi apo jo, është vetëm seanca plenare. Deri më sot ne nuk e dimë që seanca plenare të jetë shprehur nëse Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik është komision përgjegjës apo komision për dhënie mendimi për këtë projektligj. Ndaj, për të respektuar Rregulloren dhe normat procedurale të deritanishme, që ka ndjekur ky parlament, kërkojmë që ky projektligj të hiqet nga rendi i ditës së sotme dhe të vijë sërish për t'u shqyrtuar në komision dhe më pas të vijë për shqyrtim në seancën e ardhshme plenare, apo kur të jetë gati.

Më falni!

Gjithashtu, vlen për t'u theksuar se nuk është hera e parë që kjo situatë ndodh në komision. Ndaj, që të mos krijojmë precedentë të njëpasnjëshëm, kërkojmë që projektligji të rikthehet për shqyrtim në komision dhe më pas të vijë për shqyrtim në parlament.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ka ndonjë koleg për t'u shprehur pro apo kundër?

Urdhëroni, zoti Balla!

Taulant Balla – Në fakt, përgjigjen e dha vetë propozuesja. Kjo është një çështje, që e zgjidh gjithmonë seanca. Nëse komisioni në fjalë do të kishte qenë komision përgjegjës, automatikisht kjo çështje nuk mund të ishte në rendin e ditës.

Komisioni i Medies është një komision për dhënie mendimi. Gjatë zhvillimit të seancës ka kohën e nevojshme, le të mblidhet dhe të japë mendimin për këtë çështje.

Për sa kohë që komisioni përgjegjës e ka shqyrtuar, kjo kërkesë le të hidhet në votim dhe le të jetë seanca, sikurse e tha edhe kolegja, që të vendosë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Kush është kundër?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Urdhëroni?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Jo, jo, për këtë çështje një herë, pastaj për procedurë.

Kush është pro? Kundër?

Atëherë, e hedhim në votim.

Kush është dakord me procedurën...?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Urdhëroni?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Unë pyeta: a ka pro, kundër, por ju nuk u përgjigjet.

Petrît Vasili – Zoti Kryetar i Kuvendit,

Përfundimisht, ne me Rregullore e kemi që seanca është sovranë për të drejtuar Kuvendin. Seanca nuk legjitimon *post factum*, pra që një gjë të vdekur e të mbaruar e voton në seancë. Ne nuk kemi çfarë të votojmë në seancë.

Në rast se seanca do të merrte një vendim për të mos shqyrtuar një çështje, do të ishim mbledhur javën që shkoi dhe do të kishim thënë: me propozim të njërit dhe me një votë kundër dhe pro të tjetrit, çështja nuk ka nevojë të kalojë në këtë komision për dhënie mendimi, sepse nuk duam, na bezdis a çfarëdo të jetë. Por nuk mund të legjitimojmë ne sot një vendim, që seanca e ka marrë dhe të themi: jemi këtu për të legjitimuar se vendimi i seancës u rrëzua ose nuk ndodhi...

Zoti Kryetar i Kuvendit, ky nuk mund të jetë një votim.

Po ju them: mund të vazhdoni ta votoni, unë nuk kam problem dhe nuk ka për të ndodhur ndonjë hata e madhe, por kjo Rregullore e parlamentit vdes me këtë veprim sot, pasi ne këtu kemi vendosur dhe komisioneve ua japim ne këtë urdhër me votë. Nuk ka rëndësi nëse është votë minorance, maxhorance, ama vendoset këtu. Por çfarë do të vendosim sot, që ne e zhbëmë vendimin, e bëmë fakt të kryer dhe do të bëjmë njëmijë sofizma?!

Çfarë halli ka, nëse këtë vendim e mori vetë seanca, nuk e morëm ne, po, është marrë nga maxhoranca?! Çdo komision të shkojë të bëjë punën e tij dhe të vijë këtu në mënyrë të rregullt.

Ku ishte motivimi gjatë javës që të thoshte: këta nuk duhet të japin mendim, sepse ndërruam mendje? Nuk ka lidhje fare me komisionin në fjalë, ka ndodhur edhe me komisione të tjera.

Nëse ne krijojmë një precedent të tillë, atëherë themi se kjo Rregullore nuk vlen më dhe

nuk kemi pse t'i referohemi as për votimin, madje, në këto kushte, as mos e votoni fare, vazhdoni diskutimin dhe mbaroi!

Pra, ose ka një Rregullore, sipas së cilës kërkohet automatikisht shtyrja e kësaj çështjeje dhe t'i jepet mundësia atij komisioni, të urdhëruar nga seanca, ta bëjë këtë punë ose, në rastin e kundërt, nuk ka më Rregullore dhe nuk kemi pse të votojmë.

Gramoz Ruçi – Sipas nenit 49, nuk ka mekanizëm tjetër, përveç seancës, që është sovranë për rendin e ditës. Kështu që mbetet vetëm elementi i votimit.

Kush është dakord që kjo çështje të hiqet nga rendi i ditës?

(Debat në sallë)

Ju lutem, ngrini kartonët!

Nuk miratohet, qëndron në rendin e ditës.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Vazhdojmë.

Ka vërejtje lidhur me procesverbalin e seancës së kaluar? Nuk ka.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju njoftoj se nga Këshilli i Ministrave janë propozuar katër projektligje, njëri prej të cilëve është kërkuar me procedurë të përsheptuar shqyrtimi.

Siç e theksova, materialet do t'i gjeni, si gjithmonë, në faqen zyrtare të Kuvendit në internet dhe titujt e tyre i keni në njoftimet në tavolinat e punës.

(Deputeti Basha flet nga vendi pa mikrofon.)

Zoti Basha, e doni fjalën për procedurë?

Tri minuta.

Lulzim Basha – Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Të dashura qytetare dhe qytetarë,

Më lejoni ta nis me një këshillë për zotin Vasili dhe deputetët e LSI-së, të cilët vazhdojnë të këmbëngulin me heroizëm për zbatimin e Rregullores në një parlament, që ka shkelur haptazi Kushtetutën, që ka shkelur ligjet dhe që ka ndërmarrë akte antikushtetuese, në dhunim flagrant të reformës në drejtësi.

T'i kërkoj këtij parlamenti të respektojë Rregulloren, t'i kërkoj kësaj maxhorance, kësaj pseudomaxhorance, të respektojë Rregulloren, është njësoj si t'i kërkoj krimit të organizuar të marrë përsipër rendin dhe sigurinë.

Zonja dhe zotërinj,

E gjitha kjo që keni parë në këto minuta është përpjekja e dëshpëruar e kësaj maxhorance dhe e kësaj qeverie, të kapur në krim e të zhytur në krim, për të dhënë përshtypjen e një fasade parlamentarë-demokratike.

Por e vërteta nuk është kjo, nuk është ky skenar i turpshëm, ky teatër kukullash, që imponohet nga kjo sallë. E vërteta është se Kushtetuta ka rënë, se Kodi Penal ka rënë, se Kodi i Procedurës Penale ka rënë, se ligji i antimafias ka rënë, se ligji i famshëm për vettingun e policisë ka rënë për sa kohë në atë karrige dhe në atë tjetër, që sot i kanë lënë bosh, për faqen e tyre të zezë, janë të ulur Fatmir Xhafaj dhe Edi Rama, të cilët janë zbuluar para mbarë shqiptarëve dhe para mbarë botës si hartuesit dhe zbatuesit e një skenari kriminal, i cili ka për qëllim të mbulojë veprimtarinë kriminale të Fatmir Xhafajt, në ndihmë të vëllait të tij, Agron (Geron) Xhafajt, një prej bosëve të drogës në Shqipëri dhe kokës së drogës në Vlorë. Ky skenar kriminal ka për qëllim të mbulojë komplotin antiligjor dhe antikushtetues, të ndërmarrë në bashkëpunim me strukturat e shtetit të kapur dhe strukturat mafioze për të shkatërruar provat, për të intimiduar, për të blerë dhe...

(Bie gongu.)

...për të kërcënuar dëshmitarët dhe denoncuesit e krimit, që shqiptarët e kanë parë, me zë dhe figurë, si dhe për t'i siguruar Fatmir Xhafajt karrigen e ministrit të Brendshëm, karrige nga e cila vazhdon të shkelë çdo sekondë ligjin, duke përdorur policinë dhe prokurorinë nën urdhra politikë, për të mbrojtur aktivitetin kriminal të vëllait të tij...

(Deputeti Basha i ndërpritet fjala.)

Gramoz Ruçi – Zoti Basha, koha për procedurë mbaroi! Mund të uleni!

Zoti Basha, do të diskutojmë për raportin e Këshillit të Ministrave, për gjetjet dhe rekomandimet e raportit të Komisionit European për Shqipërinë. Të gjitha këto që reklamoni, mund t'i reklamoni shumë mirë nëpërmjet debatit duke diskutuar, debatuar dhe duke paraqitur gjithçka që mendoni. Kjo shfaqje e shëmtuar e radhës, tregon se sa të gatshëm jeni dhe çfarë mesazhi do të çoni në mbledhjen e qershorit.

Ndërpritet seanca.

10 minuta pushim.

(Rifillon seanca.)

Gramoz Ruçi – Zoti Basha, edhe një herë ju kërkoj të lejoni zhvillimin normal të seancës!

Në pikën e parë të rendit të ditës kemi një çështje shumë të rëndësishme për diskutim, siç është paraqitja e raportit “Për gjetjet dhe rekomandimet e raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë, 2018”. Është një rast i artë për opozitën që të debatojë, të kritikojë dhe të paraqesë alternativat e veta për një çështje kaq të madhe.

Ky është protagonizmi real i opozitës, kurse veprimet tuaja për të marrë peng seancën, sigurisht nuk janë alternativat e një opozite që kërkon të vijë në pushtet.

Edhe një herë, në zbatim të Rregullores, ju kërkoj të lironi foltoren që qeveria të paraqesë raportin! Mandej, sipas listës së gjatë që keni paraqitur prej 38 diskutantësh, të paraqisni gjithë arsenalin tuaj të argumenteve, pretendimeve, vërejtjeve, sugjerimeve, të dakordësisë apo kundërshtimeve për progresraportin e Komisionit të Bashkimit Europian.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Çfarë të ndjekë, uzurpimin tuaj të foltores?!

(Diskutim nga salla pa mikrofon.)

Zoti Basha, të lutem, ulu! Je alternativa e pushtetit dhe duhet të dish që qeveria ka detyrimin ligjor që brenda tri javëve të sjellë raportin. Këtë raport e ka depozituar brenda kësaj kohe, por fatkeqësia e këtij vendi dhe e kësaj maxhorance është që opozita nuk është në gjendje të bëjë opozitarizmin e saj për këtë raport.

(Diskutime nga salla pa mikrofon.)

Ndërpritet seanca!

(Më pas opozita largohet nga salla.)

(Rifillon seanca)

Gramoz Ruçi – Të hyjë media!

Vazhdojmë seancën. Siç ju kam njoftuar, sipas nenit 18, pikës 2, të ligjit nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit në Bashkimin Europian”, Këshilli i Ministrave brenda tri javëve paraqet në Kuvend raportin, i cili është depozituar prej disa ditësh. Të gjithë deputetët e kanë përpara raportin, por mund ta gjeni edhe në faqen zyrtare të Kuvendit.

Ftoj ministrin e Jashtëm, zotin Bushati, të paraqesë shkurtimisht gjykimet dhe vlerësimet e qeverisë lidhur me rekomandimin e raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2018.

Zoti Bushati, fjala për ju!

Ditmir Bushati – Zoti Kryetar,

Kolegë deputetë,

Në zbatim të ligjit “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit në Bashkimin Europian”, Këshilli i Ministrave duhet t’i dorëzojë Kuvendit një raport në lidhje me raportin vjetor të Komisionit Europian, për gjetjet dhe rekomandimet e tij, për qëndrimin e Këshillit të Ministrave rreth raportit dhe për rrugën që duhet ndjekur për të zbatuar gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti.

Më lejoni që, në emër të qeverisë, të konstatoj se për herë të parë që nga viti 2009, kur Shqipëria ka aplikuar për të qenë vend anëtar i Bashkimit Europian, kemi një rekomandim të qartë, pa asnjë ekuivok dhe pa asnjë kushtëzim nga ana e Komisionit Europian. Kanë kaluar 9 vjet nga aplikimi i Shqipërisë për anëtarësim në BE dhe shihet qartë se koha nuk punon për ne, por jemi ne që duhet të punojmë për kohën dhe të mos humbasim asnjë moment më shumë në rrugën drejt transformimit të mëtejshëm për t’u bërë pjesë organike e Europës së Bashkuar.

Siç jeni në dijeni, në vitin 2016 Komisioni Europian rekomandoi nisjen e bisedimeve për anëtarësim me Shqipërinë, me mirëkuptimin që Shqipëria do të zbatonte ligjin për vetingun. 16 muaj më vonë, më 17 prill, Komisioni Europian rekomandon qartazi nisjen e bisedimeve për anëtarësim, bazuar jo vetëm në zbatimin e ligjit për vetingun, por edhe në ecurinë e përmbushjes së pesë prioritetëve kyçe, që Bashkimi Europian vendosi si prioritete për anëtarësimin e Shqipërisë.

Paketa e Zgjerimit e vitit 2016 shtoi për herë të parë kriteret e reja të vlerësimit të vendeve të paketës, duke përfshirë jo vetëm progresin e vendeve krahasuar me vitet e mëparshme, por dhe nivelin e përgatitjes së tyre për të qenë vend anëtar, të shtrirë në të gjitha kriteret e Kopenhagenit, përfshirë të gjithë kapitujt e *acquis*. Një metodologji e tillë është më e ndryshme dhe më strikte sesa ajo e përdorur për raportimin e Komisionit për vendet e anëtarësuar më rishtazi, si: Rumania, Bullgaria e Kroacia, dhe e bën monitorimin e procesit të integritimit europian më të detajuar, më të gjithanshëm, më ambicioz, për rrjedhojë më sfidues për vendin tonë.

Po ashtu, ky raport vjen pas publikimit të strategjisë së Komisionit Europian për transformimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor më 6 shkurt të këtij viti, ku Komisioni propozoi 6 iniciativa pararojë për zhvillimin, transformimin dhe europianizimin e mëtejshëm të rajonit, duke përfshirë këtu: forcimin e sundimit të ligjit në rajon; përmirësimin e ndërlydhjes në fushën e transportit dhe energjisë; zhvillimin ekonomik-social të rajonit; zgjidhjen e çështjeve dypalëshe; angazhimin e përbashkët dhe forcimin e ndërveprimit midis BE-së dhe rajonit në fushën e sigurisë, emigracionit dhe në ndërlydhjen më të mirë dixhitale.

Kjo është strategjia e parë e Komisionit, pas asaj të vitit 2002, në prag të anëtarësimit të 10 vendeve të Europës Qendrore e Lindore, gjë që tregon qartë vëmendjen e shtuar të Bashkimit Europian për rajonin tonë, kryesisht ndaj forcimit të shtetit të së drejtës, perspektivës zhvillimore dhe kapërcimit të problematikës dypalëshe në të gjithë rajonin tonë.

Kjo qasje holistike e Komisionit Europian, e cila kombinon fokusin në kriteret politike, social-ekonomike, si dhe dinamikën ndërshtetërore në funksion të përgatitjes së vendeve të rajonit për anëtarësim në Bashkimin Europian, përbën busullën orientuese për punën tonë në drejtim të thellimit të reformave dhe ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kontekst, duam të ndajmë vlerësimin që Komisioni bën për aspektet politike dhe ekonomike.

Në lidhje me funksionimin e institucioneve demokratike, Paketa e Zgjerimit përmend si pozitive marrëveshjen ndërpartiake të muajit maj të vitit 2017, e cila lejoi jo vetëm rifillimin e

aktivitetit të Kuvendit të Shqipërisë përpara mbylljes së legjislaturës dhe zhvillimin e rregullt të zgjedhjeve, por edhe miratimin e shumë akteve, që lidhen me zbatimin e reformave në 5 fushat kyçe me konsensus politik.

Në lidhje me kriterin ekonomik, vlerësimi i Komisionit Europian është se Shqipëria ka bërë progres të vazhdueshëm dhe është e përgatitur, në një nivel mesatar, për zhvillimin funksional të ekonomisë së tregut. Vlerësohet rritja e aftësisë së ekonomisë shqiptare për të përballuar konkurrencën, veçanërisht vlerësohet përparimi në fushën e infrastrukturës, të energjisë dhe të transportit.

Në lidhje me përmbushjen e 5 prioritetëve, dëshirojmë të veçojmë disa prej vlerësimeve të Komisionit Europian, duke iu referuar progresit të shënuar në krahasim me vitin 2016, ose raportit të mëparshëm të Komisionit.

Për sa i përket reformës në drejtësi, raporti përmend specifikisht se Shqipëria mund të konsiderohet një shembull për t'u ndjekur edhe nga vendet e tjera të rajonit, për procesin e vlerësimit të figurës së gjyqtarit dhe prokurorit, ngritjes së institucioneve në fushën e drejtësisë, thënë ndryshe, arkitekturës së re në sistemin e drejtësisë.

Lufta kundër korrupsionit. Përmendet rritje në vlerësimin e Komisionit për luftën kundër korrupsionit, nga "progres", që ishte në raportin e vitit 2016, në "progres të mirë" në raportin e vitit 2018.

Lufta kundër krimit të organizuar. Shënohet progres në identifikimin dhe shkatërrimin e mbjelljeve të kanabisit. Ligji antimafia dhe ai i Kodit Penal krijuan kushtet për rritjen e eficientës në hetim dhe në intensifikimin e bashkëpunimit të policisë me vendet anëtare të Bashkimit Europian. Po ashtu raporti u referohet operacioneve ndërkombëtare, ku roli i institucioneve ligjzbatuese në Shqipëri, për sa u përket trafikeve të ndryshme, u konsiderua vendimtar.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për politikat e azilit ku ka jo vetëm përputhshmëri të plotë për sa i përket kuadrit ligjor dhe institucional, por edhe angazhime të qarta të autoriteteve shqiptare me vendet partnere të Bashkimit Europian, të cilat u prekën nga fenomeni i migracionit të paligjshëm.

Po kështu, për sa u përket lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, sipas raportit të Komisionit Europian, liria e shprehjes njihet përmirësim, nga vlerësimi që ishte në vitin 2016 “pa progres”, në vlerësimin “me progres” në vitin 2018.

Përmenden masat për kthimin dhe kompensimin e pronave që janë ndërmarrë nga autoritetet shqiptare, në linjë me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, sikundër përmenden miratimi i kuadrit të ri ligjor për pakicat kombëtare dhe puna që po bëhet në këtë drejtim për aktet dytësore.

Në mesataren e vlerësimit të përparimit të Shqipërisë në të gjithë kapitujt gjatë periudhës së raportimit, mund të thuhet se Shqipëria zë vendin e dytë në rajon, pas Malit të Zi që, në fakt, është edhe vendi më i avancuar në këtë proces për shkak se ka hapur rreth 30 kapituj të negociatave për anëtarësim. Kjo tregon se kemi bërë progres edhe në përafrimin e legjislacionit dhe të standardeve tona me ato të Bashkimit Europian.

Shqipëria vlerësohet si mesatarisht e përgatitur në shumë sektorë, si: kontrolli financiar, arsimi, kultura dhe me njëfarë niveli përgatitjeje në sektorë të tjerë vendimtarë, siç janë prokurimet publike dhe statistikat.

Raporti vlerëson se kemi arritur shkallën e plotësimin të kriterëve që kërkohen për këtë fazë të procesit të integritetit europian, që është hapja e negociatave për anëtarësim.

Të nderuar kolegë, rruga që nga aplikimi ynë e deri më sot, siç shihet, nuk ka qenë një rrugë e shkurtër. Rruga që na pret përpara është edhe më sfiduese me hapjen e negociatave, që do të shënonin një gur kilometrik në këtë proces.

Për qeverinë shqiptare, përparimi i njohur nga Komisioni Europian, është nxitje e mëtejshme për të përshpejtuar ritmin e reformave të ndërmarra. Qeveria shqiptare ka vullnet të plotë për të ecur në rrugën e reformave, në frymën e mirëkuptimit ndërpartiak në Kuvend dhe në bashkëpunim të plotë me shoqërinë civile dhe grupet e interesit.

Hapat e mëtejshëm të procesit të anëtarësimit do të kërkojnë përkushtim dhe rritje të profesionalizmit të administratës dhe institucioneve të tjera publike. Ne synojmë forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale dhe të bashkëpunimit e mirëkuptimit ndërinstitucional, si parakusht për

përballjen me negociatat e anëtarësimit, që, në fakt, do të jetë procesi më intensiv i reformave transformuese që ka përjetuar ndonjëherë vendi.

Ndaj, ne përshëndesim nismën e sotme të Kuvendit të Shqipërisë për rezolutën, që u bën thirrje të gjitha vendeve anëtare të Bashkimit Europian për të mbështetur rekomandimin e Komisionit Europian për nisjen e bisedimeve për anëtarësim me Shqipërinë. E mbështesim, sepse ne besojmë se procesi i integritetit europian është mundësi unike, e papërsëritshme për të gjithë në për emancipimin politik.

Sa më shumë afrohemi në procesin e integritetit europian, aq më shumë rriten presioni pozitiv dhe kërkesat e Komisionit dhe vendeve anëtare për zbatimin e reformave shtetkonsoliduese dhe shërimin e plagëve të dy dekadave të fundit. Por ky presion është edhe test për të gjithë. Disa prej nesh kanë zgjedhur t'i përgjigjen këtij presioni pozitiv me frikë, paranojë, bllokim dhe nxirje të imazhit të Shqipërisë me çdo kusht dhe në çdo rast, duke përdorur çdo platformë dhe tryezë ndërkombëtare ku i ka çuar vota e shqiptarëve, për të nxirë perspektivën europianëve të vetë shqiptarëve.

Kjo shumicë ka zgjedhur rrugë tjetër: atë të ndryshimit, të transformimit dhe të shtetkonsolidimit, duke marrë parasysh të gjitha kostot, për të gjithë vendin, për të gjithë institucionet, deri edhe për familjen tonë politike.

Mes nesh nuk ka vend për shterpësi të imagjinatës politike, sepse projekti i integritetit europian është një projekt ndërtimi i institucioneve, i kulturës demokratike dhe i lidhjes së një kontrate të mirëfilltë me qytetarët dhe shoqërinë shqiptare.

Mesazhi i dytë, që duam të japim sot këtu, është se kostoja e çdo vonese, bllokimi apo pengimi të procesit nga mosdija apo mosdashja është kosto për të gjithë shqiptarët.

Reformat tona, kryesisht në fushën e sundimit të së drejtës, thellimi i bashkëpunimit me vendet anëtare në fusha të tilla, si lufta kundër krimit të organizuar, përbën një shembull dhe një faktor kontribues për sigurinë në të gjithë Ballkanin Perëndimor, dhe si rrjedhojë ndikon drejtpërdrejt te shqiptarët kudo ku ata jetojnë.

Kur flitet për shqiptarët e lidhur me krimin në Europë, nuk jemi ne këtu në këtë sallë që ndikohemi drejtpërdrejt nga perceptimet

negative, por janë të gjithë shqiptarët jashtë kësaj sale dhe të gjithë shqiptarët në rajon.

Vendimi pozitiv për çeljen e negociatave për Shqipërinë është një lajm i mirë për të gjithë rajonin dhe humbja e këtij rasti do të na ekspozonte ne, do të ekspozonte rajonin dhe vetë BE-në ndaj rrymave destabilizuese dhe pasigurisë.

Mesazhi i tretë ka lidhje me orientimin e qartë dhe të paekuvok proeuropean dhe proatlantik të kësaj shumice. Politika jonë e linjizimit 100% me politikën e jashtme e të sigurisë së Bashkimit European ka krijuar një standard të ri, i cili në mënyrë të vazhdueshme e konsistente vlerësohet nga Bashkimi European si partneri ynë strategjik, si një nga asetet më të çmueshme të politikës sonë të jashtme dhe kontribuesit kryesorë për paqen e sigurinë në rajon.

Natyrisht, klima e disa prej vendeve anëtare të BE-së, për sa i përket ecurisë së procesit të zgjerimit, nuk është klima më e mirë e mundshme ku zhvillohet ky proces, por besojmë se me komunikim intensiv qoftë në nivel qeveritar, por edhe në nivel parlamentar, do të jemi në gjendje për të bërë edhe hapat e fundit në procesin e nisjes së bisedimeve për anëtarësim.

Ndaj, duke përfunduar, dua, në emër të qeverisë shqiptare, të falënderoj të gjithë deputetët për kontributin që kanë dhënë në këtë proces!

Faleminderit!

(Drejtimit e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushati! Fjalën e ka deputeti Taulant Balla.

Taulant Balla – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste kemi depozituar për miratim rezolutën për rekomandimin e Komisionit European për hapjen e negociatave midis Bashkimit European dhe Shqipërisë.

Do të kishim dashur shumë që, në frymën e ligjit për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integritetit european dhe në frymën e Kushtetutës së vendit, të kishim pasur mundësinë që këtë rezolutë ta miratonim së bashku me opozitën. Megjithatë, detyrë e Kuvendit të Shqipërisë, ashtu siç ia ngarkon ligji, është ta miratojë këtë projektrezolutë në seancën e sotme.

Në respekt të mbështetjes së gjerë popullore për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, duke riafirmuar se objektivi strategjik i Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin European; duke riafirmuar mbështetjen tonë të palëkundur për të respektuar vlerat mbi të cilat ndërtohet Bashkimi European dhe vendosmërinë tonë për zhvillimin e një shoqërie demokratike, bazuar në sundimin e ligjit, në respektin për të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e minoriteteve dhe parimet e ekonomisë së tregut; duke theksuar vendosmërinë tonë për konsolidimin e një kuadri ligjor tërësisht të përputhur me legjislacionin e Bashkimit European dhe për një administratë publike eficiente për zbatimin e këtij legjislacioni; duke vlerësuar se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në Bashkimin European dhe se bashkëpunimi rajonal është pjesë e pandarë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin European; duke nënvizuar rëndësinë gjeopolitike të procesit të zgjerimit, si për shtetet kandidate apo ato kandidate potenciale, ashtu edhe për vetë Bashkimin European; duke vlerësuar mbështetjen që Bashkimi European i ka dhënë Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe zhvillimin e saj ekonomiko-social, me bindjen se përparimi i Shqipërisë në procesin e anëtarësimit bazohet tërësisht në meritë dhe në përputhje me reformat dhe arritjet konkrete; duke besuar plotësisht se anëtarësimi në Bashkimin European do të kontribuojë në zhvillimin e gjithanshëm të Republikës së Shqipërisë në forcimin e sigurisë kombëtare, në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve shqiptarë; duke marrë në konsideratë zbatimin e mirë dhe të qëndrueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve europiane e shteteve të tyre anëtare; duke marrë në konsideratë përparimin e bërë nga Shqipëria në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit European; duke marrë në konsideratë rekomandimin e Komisionit European për hapjen e negociatave, si konfirmim përparimi të bërë nga Republika e Shqipërisë; duke marrë në konsideratë se rekomandimi i Komisionit për hapjen e negociatave të anëtarësimit është një nxitje për të përshpejtuar reformat e gjithanshme, në veçanti reformën në drejtësi; duke marrë

parasysh rekomandimet e Komitetit ndërparlamentar të Stabilizim-Asociimit, Shqipëri-BE; duke marrë në konsideratë reformat e ndërmarra në kuadër të procesit të integritetit europian si, reforma në drejtësi dhe reformat e tjera për konsolidimin e funksionimit të shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut; duke marrë në konsideratë faktin që dialogu politik, i realizuar nëpërmjet gjithëpërfshirjes dhe transparencës, është elementi kyç për përparimin e Shqipërisë në procesin e integritetit europian, sot Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shprehet me këtë deklaratë:

“Mirëpresim raportin e Komisionit Europian të vitit 2018 për progresin dhe shkallën e përgatitjes për anëtarësim të arritur nga Shqipëria. Vlerësojmë rekomandimin e Komisionit Europian për hapjen e negociatave të anëtarësimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, si njohje e qartë e arritjeve të Shqipërisë në ndërtimin e shtetit të së drejtës, specifikisht me reformën në drejtësi, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, reformën në administratën publike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

U bëjmë thirrje njëzëri vendeve anëtare të Bashkimit Europian të marrin vendimin për fillimin e negociatave të anëtarësimit midis Bashkimit Europian dhe Shqipërisë, si fillimi i një rruge për shndërrimin e mëtejshëm europianizues të vendit, me vetëdijen se kjo do të jetë një rrugë e vështirë dhe e gjatë, por hapja e negociatave do t'i japë shpresë këtij rrugëtimi. Shprehim vullnetin tonë të plotë për të ecuar në rrugën e nisur të reformave, në frymën e mirëkuptimit partiak dhe në bashkëpunim të plotë me shoqërinë civile. Theksojmë se angazhimi i qëndrueshëm për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Europian dhe të institucioneve të tjera ndërkombëtare përbën përparësinë kryesore të punës së Kuvendit të Shqipërisë, të qeverisë dhe të gjitha institucioneve të tjera.

Angazhohemi se do të shqyrtojmë me prioritet projektligjet, që synojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian apo që kanë rëndësi për procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian.

I kërkojmë qeverisë të thellojë dhe të përshpejtojë ritmin e reformave të ndërmarra,

veçanërisht të reformave që lidhen me sundimin e ligjit.

I bëjmë thirrje qeverisë që rekomandimet e Paketës së Zgjerimit të vitit 2018 të shërbejnë si udhëzues në përpjekjet për përshpejtimin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian!

Angazhohemi se do të përdorim çdo instrument të diplomacisë parlamentare, në funksion të përshpejtitimit të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Angazhohemi se do të zhvillojmë me forcë, edhe më tej, aktivitetin e Këshillit Kombëtar për Integritetin Europian, të cilin ia kemi besuar opozitës, për rritjen e transparencës në procesin e integritetit europian, nëpërmjet gjithëpërfshirjes së aktorëve pjesëmarrës.

I kërkojmë qeverisë shqiptare që të forcojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe të zgjerojë pjesëmarrjen në nismat rajonale!

I kërkojmë qeverisë që të zgjerojë pjesëmarrjen në procesin e Berlinit, duke përmirësuar hartimin dhe zbatimin e projekteve të ndërlidhshmërisë.”

Kjo është rezoluta, për të cilën ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit ta votojnë! Do të kisha dashur shumë, edhe një herë, që këtë rezolutë ta votonin edhe deputetët e opozitës, megjithatë detyra jonë është që këtë proces ta çojmë përpara!

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka kërkuar Kryeministri Rama.

Edi Rama – Këtu në sallë ka jo pak deputetë, të cilët kanë qenë pjesë e trupës parlamentare të Republikës së Shqipërisë edhe kur u bë një rezolutë për liberalizmin e vizave dhe Partia Socialiste ishte në bojkot parlamentar. Nuk dua t'u kthehem arsyeve të atij bojkoti parlamentar, por po e sjell në vëmendje të publikut këtë fakt për të nënvizuar se sot është hera e parë në historinë e parlamentarizmit demokratik shqiptar që një parti politike braktis sallën e Kuvendit kur bëhet fjalë për një rezolutë me interes kombëtar të kësaj natyre.

Kujtoj se asokohe Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste erdhi në Kuvend, kontribuoi në hartimin e asaj rezolute dhe e votoi rezolutën në unanimitet me Partinë Demokratike, në atë kohë në qeveri.

Kujtoj po ashtu se, ndërkohë që Shqipëria priste të merrte ftesën për t'u anëtarësuar në

NATO, ndodhi katastrofa e Gërdecit, me pasojë vdekjen e 26 njerëzve të pafajshëm, shkatërrimin e pronës dhe çative të një fshati të tërë, plagosjen e shumë burrave, grave dhe fëmijëve. Në atë kohë ne u kritikua, unë personalisht u kritikova nga shumëkush, pikërisht sepse nuk e kthyem atë moment tragjik në një mjet politik, për të cenuar një proces, që ishte drejt finalizimit të tij, anëtarësimin e Shqipërisë në NATO.

Dhe ja sot, kur jemi në metrat e fundit të një ruge shumë të gjatë dhe kur parlamenti ka për detyrë të bëjë përpjekjen e tij për të votuar një rezolutë, e cila nuk është e njëanshme, por është shprehje e vullnetit të të gjithë qytetarëve shqiptarë, qofshin zgjedhës të Partisë Socialiste, qofshin zgjedhës të Partisë Demokratike, ndodh ajo që s'ka ndodhur kurrë. Partia Demokratike bën atë që nuk e ka bërë kurrë as vetë ajo, kur në të shkuarën e largët ka qenë në opozitë dhe situata ka qenë nganjëherë shumë e ngarkuar politikisht, ikën nga salla. Partia Demokratike refuzon të votojë një rezolutë, e cila nuk është një akt i të folurit me vete, por është një akt vullneti i parlamentit për t'u bërë me dije të gjithë vendeve anëtare të Bashkimit Europian se Parlamenti i Shqipërisë në unanimitet kërkon çeljen e negociatave.

Kjo rezolutë, nga një shprehje e vullnetit të mirë duke u votuar vetëm nga ne, kthehet në një tjetër problem, në përpjekjen tonë për të bindur të gjitha vendet anëtare, sepse është e njëanshme. Cilido në korridoret e parlamenteve europiane që është kundër çeljes së negociatave me Shqipërinë, apo me Maqedoninë, sepse është kundër vizionit të zgjerimit të Bashkimit Europian, këtë rezolutë mund ta ketë një arsye më shumë për të trokitur nëpër dyert e atyre korridoreve dhe për t'u thënë të tjerëve se Parlamenti i Shqipërisë nuk është unanimitet për çeljen e negociatave. Shikoni, një rezolutë e bërë vetëm nga shumica qeverisëse! Opozita nuk ka marrë pjesë, nuk ka votuar.

Natyrisht që në Berlin, në Paris, në Hagë apo kudo qoftë tjetër këta lloj individësh nuk lënë argument pa shfrytëzuar, por ndërkohë të tjerët nuk mund të bëhen me faj nëse nuk kanë as kohën dhe as mundësinë të hyjnë më thellë dhe të kuptojnë si qëndron e vërteta. Kështu i gjithë procesi i përpjekjes sonë, shumë të vështirë, për të bindur të gjithë që në fund të qershorit të na japin atë që meritojmë, shoqërohet nga një

proces paralel, po nga Shqipëria, për t'i bindur që të mos ia japin Shqipërisë atë që meriton.

E vërteta është se, absolutisht, të gjithë ata që merren me Shqipërinë, edhe ata të cilët janë në pozicion kundërshtues, e kanë shumë të vështirë të kuptojnë se si ka mundësi që Shqipëria është i vetmi rast, në të gjithë historinë e procesit të integritetit, qëkur ra perandoria komuniste dhe filloi afrimi e pastaj integrimi i vendeve ish-komuniste në BE, ku nuk ka konsensus dhe nuk ka unitet kombëtar në komunikimin me të huajt, por ka një opozitë, që nuk lë gurë pa lëvizur për ta shkatërruar këtë proces. I vetmi.

Ne e dimë shumë mirë jetën politike dhe ecurinë e zhvillimeve politike në Maqedoni. Ne e dimë shumë mirë se sa e vështirë është bashkëjetesa në Maqedoni mes shumicës dhe opozitës, por as dje dhe as sot, as opozita dje dhe as opozita sot, nuk janë pjesë e diçkaje sadopak të ngjashme me këtë që ndodh këtu. Jeta politike në Bullgari është jashtëzakonisht konfliktuale, por qyshkur filloi përgatitja për presidencën bullgare, shumica dhe opozita u bënë bashkë dhe u ulën në tryezë, diskutuan dhe formuluan të gjithë programin e presidencës bullgare, sepse brenda kufijve është familja e madhe e një populli, ku, si çdo familje, ka mendje të ndryshme. Por jashtë kufijve populli është një, vendi është një, shteti është një, flamuri është një. Nuk shkohet në asnjë vend, sapo kapërcen kufirin, me flamurin e partisë në dorë. Sapo kapërcen kufirin është vetëm një flamur, ai i Shqipërisë, flamuri i vendit. Kur kapërcen kufirin nuk je më një socialist apo një demokrat i vendit tënd, por një shqiptar, që përfaqëson vendin tënd dhe ata që të shohin, që të dëgjojnë dhe që të flasin nuk të shohin, nuk të dëgjojnë dhe nuk të flasin si socialist apo si demokrat, por si përfaqësues i një vendi, i cili po kërkon të hedhë një hap historik për t'u afruar përfundimisht me një familje vendesh, ku gjëra të tilla janë të paimagjinueshme.

Askush si këta, fatkeqësisht, dhe është fatkeqësi e madhe për këtë vend dhe për njerëzit e tij, sepse ky vend e ka sot një bekim. Ky është i vetmi vend ku nuk ka një forcë të strukturuar antieuropiane, ashtu sikundër nuk ka asnjë parti komuniste. Në këtë vend myslimanë dhe të krishterë, nga Veriu apo nga Jugu, të rinj apo të moshuar, nëse kanë 1001 sebepe për të qenë të

ndarë në opinione për 1001 gjëra, kanë një mendim të njëjtë, një qëndrim të njëjtë, një shpresë të njëjtë dhe një ëndërr të njëjtë për të qenë pjesë e familjes europiane.

Thyerja brutale e kësaj pasqyre shpirtërore të një populli të tërë për qëllime dhe arsye, që nuk kanë lidhje fare me interesat kombëtare, me interesat e një populli të tërë, apo me interesat e të gjithë atyre që nuk duan ta shohin me sy PS-në, që nuk duan ta shohin me sy qeverinë, që kanë votuar dhe votojnë për PD-në, është një akt i pashembullt pabesie historike ndaj këtij vendi dhe ndaj këtij populli. I pashembullt, nuk ka një të dytë. Shqipëria ka pasur plot individë me akte të pashembullta pabesie dhe tradhtie në histori, por një forcë e tërë, e organizuar dhe e votuar, që nuk sillet si Partia Demokratike e Shqipërisë, që lindi me thirrjen: “E duam Shqipërinë si e gjithë Europa”, por si një forcë, që për program ka testamentin e Esat Pashës. Kjo është e pabesueshme!

Pyetja është shumë e thjeshtë. Pse? Çfarë arsyes kanë këta që sillen kështu? Të jetë vallë thjesht arsyeja e pushtetit? Të jetë vallë thjesht ambicia e verbër për t’u rikthyer në pushtet? Nuk mjafton. Është shumë e vështirë të thuash: “Po, kjo është dhe nuk ka tjetër”. Mund të jetë dhe mbase është pjesërisht, por nuk është ky thelbi. Nuk mund të jetë ky motivi, që, pa u mbushur ende një vit nga zgjedhjet, një forcë e tërë politike, alternative të transformohet në një fuqi, që gjakon për shkatërrim, për shkatërrimin e një segmenti rruge, që është rruga e shqiptarëve, nuk është rruga e Partisë Socialiste, nuk është rruga e një pjese, është rruga e shqiptarëve.

Çelja e negociatave është një problem shumë i madh për ta jo thjesht për arsyen se, duke u çelur negociatat, qeveria dhe shumica jonë me gjasë do të marrë një energji të re besimi dhe mbështetjeje, por sepse, duke u çelur negociatat mbaron përfundimisht historia e pandëshkueshmërisë. Duke u çelur negociatat vendi kalon nga një fazë, ku mjaftonte të bënte ndryshimin e Kushtetutës, ndryshimin e të gjithë arkitekturës së sistemit të drejtësisë, ndryshimin e ligjeve që garantonin pastrimin e sistemit të drejtësisë, në një fazë ku vendi duhet të tregojë se prokuroria dhe gjykatat e pastruara nga vetingu funksionojnë si një pushtet, që nuk i ndan njerëzit në të fortë e në të dobët, në të pasur dhe në të varfër, në të pushtetshëm dhe të

pazëshëm, por si një pushtet, ku gjithkush që ka shkelur ligjin, gjithkush që ka kryer akte në dëm të interesave publike, gjithkush që ka prekur pasurinë e shqiptarëve ndëshkohet.

Ky është themeli i gjithë kësaj përpjekjeje prej barbarësh në mes të Europës, në kulmin e këtyre përpjekjeve, të cilat janë strategjike edhe për një arsye tjetër, sepse ky vit është themelor për Europën që lëkundet nga presioni i forcave dhe i grupimeve që janë kundër saj.

Si sot një vit do të bëhen zgjedhjet në Europë. Ndryshon Parlamenti European dhe askush nuk di ta thotë se sa shumë do të ndryshojë për keq, jo për mirë, në drejtimin që na intereson neve. Ndryshon Komisioni European dhe askush nuk di ta thotë se çfarë Komisioni European do të kemi dhe sa do jetë i prirur Komisioni i ardhshëm European të vazhdojë punën e Komisionit të sotëm European, që është një Komision tërësisht proeuropeanist, dhe historia e negociatave të Shqipërisë, edhe e Maqedonisë, por ne flasim për Shqipërinë, mund të shtyhet në pafundësi. Këta e dinë.

Midis vrasjes së kësaj ëndërr, varrosjes së kësaj shprese dhe rritjes së mëtejshme të pasigurisë së të rinjve se në cilin vend do të jetojnë nesër, në Europë apo në një vend jashtë Europës, dhe frikës së tyre nga drejtësia, ambicies së tyre të verbër për pushtet, si dhe shurdhërisë së tyre për të dëgjuar zërin e arsyes kombëtare, këta zgjedhin të dytën, zgjedhin frikën, zgjedhin ambicien e verbër, zgjedhin edhe shurdhërinë ndaj zërit të arsyes kombëtare.

Unë kam shumë besim që në fund Shqipëria dhe shqiptarët do t’ia dalin. Kur them “në fund”, nuk them “në fund të jetës sonë”, por në fund të qershorit. Është shumë e vështirë, sepse nuk ka lidhje me Shqipërinë, nuk ka lidhje me çfarë kemi bërë ne apo me çfarë nuk kemi bërë ne. Në samitin e Sofjes ishte më e qartë se asnjëherë, sepse ishin të gjithë aty, që nuk vihet në diskutim se sa shumë përpjekje e sa shumë rezultate ka arritur Shqipëria, dhe sa shumë përpjekje titanike po bën Maqedonia, të cilës i kërkohet të ndryshojë emrin e vendit dhe jo vetëm emrin e vendit, por të ndryshojnë edhe emrin me të cilin thirren, që u kërkohet të mos thirren më maqedonas, por të thirren me një emër tjetër.

Ashtu sikundër askush nuk vë në diskutim që Shqipëria është shumë më përpara në prag të

hapjes ë negociatave, se sa çdo vend tjetër në pragun e hapjes së negociatave. Të gjithë e dinë, të gjithë e flasin dhe të gjithë e duartrokasën reformën në drejtësi, posaçërisht këtë pastrim radikal të sistemit të drejtësisë, që ka filluar. Është një revolucion paqësor, por shumë i pamëshirshëm.

Kush e ka bërë?

Komisioni Europian ka filluar të shtrojë, dhe pak nga pak do të formulojë kërkesën konkrete për Serbinë, për Malin e Zi, që janë duke negociuar, që t'i referohen modelit të Shqipërisë, e padyshim për Maqedoninë, për Kosovën, për Bosnjën nuk diskutohet, sepse është e shkruar në paketën e re të zgjerimit. Është e shkruar në Raportin e Progresit, është një model për t'u shtrirë në gjithë rajonin.

Të gjithë e dinë, askush nuk e diskuton, se sa shumë ka bërë Shqipëria në gjithë këto vite kundër drogës, sepse këtu hi syve mund t'u hidhet atyre që sytë i kanë, por nuk duan të shikojnë; tapa veshëve mund t'u futen atyre që veshët i kanë, por nuk duan të dëgjojnë, por të tjerët e dinë shumë mirë. Dinë faktet! Dinë historinë! Ashtu sikundër dinë se sa shumë ka bërë Shqipëria kundër krimit të organizuar.

Sot paradite, në Holandë është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë dhe Ministrisë së Sigurisë dhe Drejtësisë së Holandës, ku ne të çojmë forca për të ndërvepruar kundër trafikut të paligjshëm të emigrantëve midis Holandës dhe Britanisë së Madhe, me të njëjtin model që kemi nisur të zbatojmë me Francën, kundër azilkërkimit të paligjshëm, me të njëjtin model që kemi nisur të zbatojmë me Gjermaninë kundër krimit të organizuar, sepse po bëhet e qartë ditatë që krimi i organizuar nuk është këtu në Shqipëri, i ndryrë në kullën e vet, nga ku jep urdhrat dhe drejton operacionet botërore, krimi i organizuar shqiptar është andej, ndërsa këtu ka bishtin, nuk ka kokën, nuk ka koka. Shqipëria në këtë mes është një partner shumë i vyer, siç tregojnë rezultatet që janë arritur, si dhe të tjera do të arrihen, qoftë në raport me emigracionin e paligjshëm, qoftë në raport me krimin e organizuar, edhe me Britaninë e madhe.

Këto të gjitha ata i dinë. Nuk kam dëgjuar ndonjërin të thotë: shiko, ne jemi të lëkundur, ose ne jemi në pozicion të pafavorshëm, sepse ju keni këtë e keni atë. Jo, fare. Sepse ata e dinë dhe

tjetrën, që, natyrisht, Shqipëria i ka këto probleme, siç i kanë dhe vende të tjera të Ballkanit, që natyrisht, Raporti i Komisionit e thotë vetë: "të gjitha këto fenomene të rrënjësura prej vitesh", por këtu nuk bëhet fjalë që ne po kërkojmë të bëhemi anëtarë të Bashkimit Europian sot. Këtu bëhet fjalë që ne të hymë në një fazë tjetër, ku këto probleme, këto fenomene, këto të këqija t'i atakojmë me shumë më tepër forcë, falë instrumentit që na japin negociatat.

Këtë e dinë. Dihet. Diskutimi s'është ky. Diskutimi është opinioni publik këtu, opinioni publik atje, partitë e ekstremist të djathtë këtu, partitë e ekstremist të djathtë atje, ekuilibrat e brendshëm këtu, ekuilibrat e brendshëm atje, se dakord, kjo është kështu, por pastaj do përdoret kështu, se do ngrihen përpjetë e do thonë: ja, ne kërkojmë të dalim fare nga Europa, këta futën në Europë edhe Shqipërinë, edhe Maqedoninë, neve na ra goja duke thënë që, si e hëngrëm këtë tek me Rumaninë dhe Bullgarinë, shikoni çfarë po na bëjnë! Pra, propaganda antieuropiane.

Sidoqoftë, unë jam besimplotë se ne do ta çajmë këtë rrugë, se ne nuk do të mbetemi në fund me derën të përplasur në fytyrë, dhe për këtë po punojmë përditë. Ministri i Jashtëm do të shkojë në Paris përsëri. Unë do të shkoj në Paris prapë e prapë. Në Berlin po ashtu.

Por ajo që di t'ju them është se nuk ka, nuk di, nuk gjej dot një krahasim me asgjë që kam jetuar dhe përjetuar, edhe në momentet më të vështira politike, sesa kjo, të kesh përballë të huaj të pushtetshëm dhe të të duhet të sqarosh: "Po si ka mundësi kjo, po si ka mundësi ajo", të këtyre.

Fatmirësisht, në fatkeqësinë e vet, historia e këtij audiopërgjimi ka një fund të qartë dhe të padiskutueshëm nga askush, sepse nuk bëhet fjalë për opinion, por bëhet fjalë për një fakt, bëhet fjalë për një provë konkrete, që, ose është autentike, ose është e fabrikuar dhe këtë nuk ka nevojë ta thotë askush këtu në Shqipëri. Dhe është qesharake.

Ajo që unë thashë dhe e përsëris prapë, është se unë e di rezultatin, sepse kam kërkuar që atë ditë ta mësoj rezultatin, por ajo që thuhet, se ky e thotë këtë që prokuroria e kapur prej këtij të thotë këtë, është qesharake, se prokuroria nuk do të thotë asgjë. Prokuroria thjesht duhet ta çojë atë material në një laborator shkencor të cilitdo vendi partner me Shqipërinë dhe t'i bëjë analizën

shkencore. Këtu nuk është çështje opinioni, është me barrë apo duket si me barrë, apo ka brenda jastëk. Këtu është çështje analizash shkencore në një laborator shkencor, që do të thotë, është ose nuk është.

Unë, që ju kam thënë publikisht se kjo është një histori banale dhe audiopërgjimi është pa lidhje fare me personin e akuzuar, po ju them se historia pas audiopërgjimit është akoma më e hatashme. Çfarë shikoni, janë vetëm aktorë, luajnë rolin. Kam shumë shpresë se nga hetimi do të dalin skenaristët, regjisorët dhe producentët. Këta janë aktorë.

Ai ditëziu i rrugëve të Vlorës është si ata figurantët e filmave të neorealizmit italian, çfarë t'i thuash, thotë, por mbrapa, historia është shumë herë më serioze se ç'duket. Sidoqoftë, se si është historia, t'ia lëmë prokurorisë. Ajo që na duhet është të vijë përgjigjja e analizës shkencore, e bërë jo nëpër kompani private, studio private apo zyra avokatie, por në një laborator shkencor të cilitdo vend partner me Shqipërinë. Kaq!

Për ta mbyllur, dua t'u bëj një pyetje shumë të thjeshtë të gjithë atyre që janë të hutuar, çoroditur, turbulluar dhe të zemëruar nga fakti se vëllai i ministrit të Brendshëm qenka trafikant aktiv droge: Çfarë do të mendoni për veten tuaj, kur kjo që unë them, të dalë siç unë po e them dhe kur të mësoni se bëhet fjalë për një tallje të madhe me të gjithë ju? Është një tallje e madhe që synon destabilizimin e vendit. Jo thjeshtë një skup mediatik, por një tallje që synon destabilizimin e vendit. Si do t'ju duket vetja kur të mësoni se keni dalë në protestë, njësoj siç shkohet në kinema për të parë një film, për të dëgjuar një film apo për të mbushur sallën e kinemasë?

Zgjedhja është e lirë, secili bën atë që do. Koha kur shkohej në protestë dhe nuk ktheheshe në shtëpi, por të çonin në morgun e spitalit në Tiranë, fatmirësisht ka vdekur. Koha kur shkoje në protestë dhe ktheheshe në ilegal, me brinjë të thyera, që mos të të kapnin më mbrapa, pasi të kishin shkatërruar me shkop e me shkelma në mes të rrugës, ka vdekur.

Në protestë mund të dalë kush të dojë, nuk e prek kush me dorë, por sigurisht duke ruajtur vijat. Pyetja këtu nuk bëhet për protestën, por për talljen e madhe. Mendojeni njëherë këtë që po ju them, thjesht që të mos ju duket vetja të

keqpërdorur me paralajmërim. Paralajmërimi është që kjo është tallje. Videopërgjimi është i fabrikuar si një videopërgjim i dikujt që nuk është fare aty. E gjitha kjo bëhet për të shkatërruar në metrat e fundit rrugën për çeljen e negociatave. Çdo shqiptar që nuk i do negociatat, duhet të shkojë në protestë, patjetër duhet të bëjë çmos për të shkuar atje dhe të mos lëvizë që aty deri sa t'ia arrijë qëllimit, pra që negociatat të mos hapen. Kush i do negociatat, duhet ta dijë që me ose pa dashje shkon atje për të kontribuar për të kundërtën. Këtë di t'ju them!

(Drejtimitin e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Kryeministër!

Kjo çështje mbyllet këtu, ngelet për t'u votuar projektrezoluta. Pra, në qoftë se për të ka sugjerime, të depozitohen.

Kalojmë në pikën tjetër, projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të dixhital-dividentit””.

A ka pyetje?

Ministri përkatës, a ka ndonjë gjë për të paraqitur?

Jo.

Komisioni jo.

Zonja Dhima?

Dakord!

Në emër të grupeve?

Zoti Suli, më falni!

Rakip Suli – Faleminderit, zoti Kryetar!

Sot do të diskutojmë dhe do të miratojmë projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të dixhital-dividentit””. Ky projektligj synon të rregullojë kuptimin e përcaktimit të pikës 3, të nenit 5, të Kreut II të ligjit nr. 34/2017.

Në pikën 3 të nenit 5, të ligjit nr. 34/2017, përcaktohet se masa e kompensimit financiar do të jetë minimalisht 5 milionë euro dhe financohet nga të ardhurat e arkëtuara nga dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave dividende numerike 1. Në çdo rast kjo masë nuk e kalon shumën prej 10% të vlerës së arkëtueshme. Përcaktimi i sipërcituar krijon konfuzion në zbatim, pasi në fjalën e parë të tij parashikohet një masë kompensimi prej 5 milionë eurosh, ndërkohë që në fjalën e dytë vendoset një tavan jo më shumë se 10%.

Pra, siç shihet, janë dy përcaktime, të cilat kundërshtojnë njëra-tjetrën, duke krijuar

vështirësi në zbatimin e ligjit dhe për këtë arsye projektligji sjell një riformulim të kësaj dispozite, duke përcaktuar një shumë fikse për kompensimin. Konkretisht, projektligji parashikon që masa e kompensimit financiar do të jetë 5 milionë euro dhe do të financohet nga të ardhurat e arkëtuara nga dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dividendit numerik 1.

Në tërësi procesi parashikon rritje të të ardhurave të buxhetit të shtetit, pasi lidhet me lirim të brezit të rëndësishëm të frekuencave të dixhital-dividentit numër 1.

Ju ftoj ta votoni këtë projektligj!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Në emër të grupeve. Zoti Pëllumbi?

Nuk ka.

Atëherë, mbyllet edhe ky projektligj.

Kalojmë në projektvendimin “Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.

Komisioni përgjegjës për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, a ka ndonjë mendim?

Zoti Shalsi?

Nuk ka.

Relatori i komisionit?

Nuk ka.

Diskutime?

Nuk ka.

Kalojmë te projektvendimi “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes””.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 28 të Rregullores, kemi një folës pro dhe një kundër. A ka folës?

Nuk ka.

Ngelet për votim.

Para se të kalojmë në votim, a jeni gati, zoti Balla?

Po.

Ju lutem, hiqni kartat e deputetëve që nuk janë të pranishëm!

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

74 deputetë janë prezentë.

Atëherë, kalojmë në votimin e projektrezolutës “Për rekomandimin e Komisionit European dhe hapjen e negociatave të anëtarësimit midis Bashkimit European dhe Shqipërisë”.

Kjo projektrezolutë është depozituar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, në mbështetje të nenit 18, pika 2, të ligjit nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin European”.

Procedura e votimit është një votim i hapur me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

73 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.34/2017 “Për lirim të frekuencave të dixhital-dividentit””.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

73 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektvendimit “Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.

Në mbështetje të ligjit nr. 9818, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike”, nga Këshilli i Ministrave propozohet kandidatura e zonjës Ketrin Topçiu, për anëtare e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Procedura e votimit është një votim elektronik i fshehtë.

Po, zoti Balla.

Taulant Balla - I nderuar Kryetar i Kuvendit, do të kërkoja që votimi për këtë çështje të bëhet në seancën pasardhëse.

Gramoz Ruçi- Dakord. Votimi për anëtarin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare shtyhet për seancën tjetër.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për shqyrtimin me procedurë të përsheptuar të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit të projektit të burimeve ujore dhe ujitëse dhe marrëveshjes së ndryshimit të huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projekteve të burimeve ujore dhe ujitëse”. Procedura e votimit është një votim i hapur me elektronikë. Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

73 vota pro.

Miratohet.

Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të ndryshuar”. Deputeti Spartak Braho, propozohet anëtar në Komisionin e Ligjeve.

Procedura e votimit është një votim, me karton.

Kush është dakord?

Miratohet.

Projektvendim “Për një shtesë në vendimin nr.100/2017 “Për caktimin e anëtarit zëvendësues në përbërje të komisioneve të përhershme të Kuvendit.” Deputeti Spartak Braho propozohet anëtar zëvendësues në Komisionin e Sigurisë Kombëtare.

Një votim i hapur me elektronikë.

Kush është dakord?

Miratohet.

Këtu mbyllet çështjet e parashikuara në rendin e ditës të seancës së sotme.

Faleminderit!

Seanca tjetër do të njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 13:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**